




Republika e Kosovës	Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës	Autoritet za Konkurenčiju - Competition Authority
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No.	299/24-01/14
Nr. i Fiq./Br. St./No. Pg.	1/3
Data/Datum/Date:	13.05.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA PRISTINA	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenčiju - Competition Authority



Nr.47/2024

Datë: 13.05.2024

Mbështetur në nenin 11 paragrafi 1.2 dhe 3 me nën paragrafët 3.1 dhe 3.2, neni 13 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, neni 15, neni 20 paragrafi 1 me nën paragrin 1.2, neni 26 paragrafi 1.2, neni 27 paragrafi 2, neni 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, neni 37, neni 38, neni 39 si dhe neni 55, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 3 i Rregullores Nr. 01/2023 për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2023 për Përcaktimin e Tregut Përkatës, sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka kryer shqyrtimin paraprak të hetimit lidhur me dyshimin e arsyeshëm se ndërmarrja Meridian Corporation Shpk, ka realizuar shitblerje të aksioneve në tregun përkatës, për të cilat përbushet detyrimi ligjor për njoftimin e përqendrimit. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 13.05.2024, nxjerr:

K O N K L U Z I O N
për fillimin e procedurës hetimore ndaj:

- I. Ndërmarrjes "Meridian Corporation Shpk", me numër unik 810482521, me adresë Prishtinë, Rruga Hyrie Hana, p.n., për shkak të dyshimeve të arsyeshme se e njejta ka realizuar shitblerje të aksioneve me qëllim përfitimin e kontrollit mbi ndërmarrjen "Spar Kosova JSC SHA" me numër unik 810118225 me adresë në, Çagllavicë, Magjistralja Prishtinë – Ferizaj, në tregun përkatës të Republikës së Kosovës., (provë: regjistri në ARBK. Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare për vitin 2020.2021).
- II. Autoriteti i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrja e lartcekur, si në dispozitivin I të këtij konkluzioni që në afat prej 30 ditësh, t'i sjell në zyrat e Autoritetit këto dokumente:
 - a) Pasqyrat financiare të Meridian Corporation Shpk, për vitet 2020,2021,2022,2023.
 - b) Marrëveshjen (kontratën) për shitblerjen e aksioneve;
 - c) Informatat e biznesit (Çertifikatën e regjistrimit, Çertifikata e numrit fiskal);
- III. Në rast se pala në procedurë nuk i dorëzon komentet dhe dokumentet e këruara si në dispozitivin II të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rreme, Autoriteti do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do t'i shqiptojë palës në procedurë, sanksionin administrativ deri në 1% të qarkullimit vjetor të vitit paraprak dhe pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur mjetet tjera ligjore të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

IV. Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës (*tutje në tekst ref. Autoriteti*), ka filluar monitorimin e tregut duke u bazuar në informatat rrethanore si dhe regjistimet në ARBK, lidhur me aktivitetet e ndërmarrjes Meridian Corporation Shpk, e cila ofron tregtinë me shumicë dhe pakicë të shitjes në tregun përkatës të Republikës së Kosovës. Andaj, Autoriteti pas mbledhjes së informatave lidhur me dyshimet për transaksionin e realizuar, rrjedhimisht blerjes së aksioneve apo fitimit të kontrollit mbi ndërmarrjet tjera në tregun përkatës, për të cilat dyshohet se përmbushin detyrimin për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim, bazuar në nenin 11 dhe 13 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta zyrtare Nr. 14/7, *më tutje në tekst: LMK*). Lidhur me këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit, ka autorizuar grupin dhe bartësin e rastit, me ç'rast Autoriteti ka filluar procedurën sipas detyrës zyrtare (ex-officio) në zbatim të nenit 36 paragrafi 3 dhe nën paragrafi 3.1.

PALË NË PROCEDURË:

Palë në procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohet ndërmarrja:

- 1. Meridian Corporation** Shpk, me numër unik 810482521, me adresë Prishtinë, Rruga Hyrie Hana, p.n.

PËRSHKRIMI I GJENDJES FAKTIKE:

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit në tregun e shitjeve me shumicë dhe pakicë në supermarketët në territorin e Republikës së Kosovës, në bazë të informatave preliminare që posdon, ekziston dyshimi i arsyeshëm se: Meridian Corporation Shpk, me numër unik 810482521, me adresë Prishtinë, Rruga Hyrie Hana, p.n., ka realizuar blerjen e aksioneve të ndërmarrjes Spar Kosova JSC SHA, me numër unik 810118225 me adresë në, Çagllavicë, Magjistralja Prishtinë – Ferizaj, e cila vepron në tregun përkatës në ofrimin e tregtinë me shumicë dhe pakicë të shitjes në tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

Autoriteti konsideron se: Transaksi/blerja është realizuar, pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për qëllimin e përqendrimit parashikuar sipas nenit 13 dhe 15 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Bazuar në nenin 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, parashihet së Pjesëmarrësit në përqendrim duhet t'i kërkojnë paraprakisht Autoritetit t'ua lejojë realizimin e përqendrimit të synuar nëse:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm; ose

1.2. së paku dy pjesëmarrës në përqendrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm.

Sipas, historikut të ndërmarrjeve në transaksion, në kohën kur ishte realizuar blerja/transaksi, palët në përqendrim përbushnin detyrimin ligjor për parashtrim të kërkesës për lejim të përqendrimit, bazuar në nenin 13 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (i shfuqizuar). Autoriteti konsideron se çdo realizim i përqendrimit të ndërmarrjeve nga nen 13 i këtij ligji, pjesëmarrësit e përqendrimit janë të detyruar ta njoftojnë Autoritetin, kur të plotësohen kushtet e përcaktuara, gjithashtu Neni 12 e përcakton shprehimisht se ndalojen përqendrimet që, mund të shtrembërojnë ndjeshëm konkurrencën efektive, veçanërisht nëse përqendrimi i tillë ka si pasojë krijimin ose forcimin e pozitës dominuese, që nënkupton se lëndët e caktuara duhet t'i nënshtrohen paraprakisht vlerësimit, nga Autoriteti i Konkurrencës.

Autoriteti konsideron se, me marrëveshjen për realizimin e bashkimit apo blerjes së aksioneve të ndërmarrjeve, në treg ka një konkurrent më pak, rrjedhimisht zvogëlohet konkurrenca në tregun përkatës, kështu që ndërmarrjet janë të detyruara të paraqesin njoftimin për Përqendrim pranë Autoritetit, për arsyet e vlerësimit të ndikimit ekonomik dhe juridik, respektivisht krijimit apo forcimit të Pozitës Dominuese, në tregun përkatës.

Me rastin e vlerësimit për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit që mund t'u paraqiten pjesëmarrësve të përqendrimit ose palëve të treta, si dhe efekteve të konkurrencës që mund t'ë lindin nga zbatimi i përqendrimit. Andaj, nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Këshillë juridike: Kundër Konkluzionit, për fillimin e procedurës hetimore, nuk është e lejuar ankesa as padia për inicimin e konfliktit administrativ.

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

Neime Binaku - Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela

Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj

Anëtare

Florent Mehmeti

Anëtar

Salihe Gashi-Loku

Anëtare

Me këtë Konkluzion të njoftohen:

- Palët në procedurë
- Arkiva

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr. 1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net